



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Nr. 02/81  
Datë: 23.03.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 23 mars 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për rregullimin e fushës së pensioneve.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTABA**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Isa MUSTABA".  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Ministarstva Rrada i Socialne Zastitne-*  
*Ministry of Labour and Social Welfare*

**KONCEPT DOKUMENTI PËR RREGULLIMIN E FUSHËS E PENSIONEVE**

Prishtinë, shkurt 2016

## Kapitulli -I

### *Hyrje - (Dokumentet ndërlidhëse)*

Për krahja për gratë dhe burrat në gjendje të rëndë socio-ekonomike dhe mbështetja e pensionistëve vazhdon të mbetet prioritet i Qeverisë së Kosovës, qëllimi i së cilës është ngritura e mirëqenies dhe realizimi i të drejtës në pension dhe përfitime të kësaj kategorie në mënyrë të dinjitetshme. Politikat sociale të shtetit të Kosovës janë përcaktuar për një shoqëri ku mbrojtja sociale dhe përfshirja e seclit qytetar, grua apo burr në secilën kategori sociale dhe të moshës, të jetë e garantuar për të bërë një jetë të dinjitetshme. Këto politika synohen të arrihen sipas standardeve të Bashkimit Evropian (BE) në kohë sa më të shkurtër të mundshme. Liria e lëvizjes së punëtorëve është njëra prej synimeve për të cilat Qeveria e Kosovës është zotuar se do t'i zbatojë si pjesë e Kapitullit të II të Programit Kombëtar për Adoptimin e Acquis-ë dhe Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim për Kosovën. Sipas këtij dokumenti, Qeveria e Kosovës është përgjegjëse që të hartojë, zbatojë dhe koordinoj legjislacionin nga fusha e sigurimeve sociale sipas Acquis-ë të BE-së.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), duke u bazuar në Programin Qeveritar 2015-2018, ku njëri nga prioritetet e këtij programi është mirëqenia sociale, në kuadër të të cilët është planifikuar si prioritet inicimi i reformave në fushën e pensioneve dhe ngritura e mirëqenies së pensionistëve. Konform këtij programi dhe dokumenteve tjera strategjike të MPMS-së, vazhdon përkrahja për pensionistët, përmes zbatimit të skemave të pagesave për kategoritë ndryshme të përfitueseve. Gjithashtu, MPMS-ja ka hartuar Strategjinë Sektoriale "Punësimi dhe Mirëqenia Sociale 2015 -2020" dhe Planin e Veprimit 2015-2016, ku jarë përcaktuar objektivat specifike dhe aktivitete për rregullimin e fushës së pensioneve dhe përmirësimin e pozitës socio-ekonomike të pensionistëve. Qeveria e Kosovës, ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2016, ku është përcaktuar edhe rishikimi i kornizës ligjore të fushës e pensioneve.

Si rezultat i kësaj, MPMS-ja ka hartuar dhe iniciuar, rishikimin e legjislacionit që mundëson rregullimin e fushës së pensioneve dhe realizimin e të drejtave në përfitime për kategoritë e ndryshme nga skemat e pensioneve të finançuara nga Buxheti i Kosovës.

## Kapitulli -II-

### *Përshkrimi i çështjes / Problemit kryesor*

Përpara konfliktit, popullsia e Kosovës mbulohej nga ish sistemi Jugosllav i pensioneve, nëpërmjet zbatimit të skemës PAYG, ku të punësuarit paguajnë kontribute duke siguruar të drejtat e përfitimeve për vete, si edhe për të mundësuar dhënien e pensioneve aktuale për pensionistët. Niveli i pensionit përcaktohej në bazë të formulës së përfitimit të përcaktuar dhe varej nga vitet e kontributeve dhe nga paga. Është me rëndësi të theksohet se para vitit 1999 nga skema e pensioneve në Kosovë mbulohej vetëm gjysma e personave të moshës mbi 65 vjeç, sepse veçanërisht në Kosovë mbulimi me elementë të sigurimeve ishte i fokusuar kryesisht tek personat e punësuar. Në atë kohë rreth 65 mijë persona trajtoheshin me pensione të moshës mbi 65 vjeç, ndërkohë që popullsia mbi këtë moshë vlerësohej të ishte rreth 107 mijë persona.

Krahas shkatërrimit të sistemit të vjetër të pensioneve, lufta në Kosovë solli si pasojë pamundësinë për të punuar dhe për të realizuar të ardhura të paktën, aq sa të plotësoheshin nevojat minimale jetësore. Situatë të rëndë ekonomike përjetuan edhe punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore të cilat mbeten pa punë dhe pa burime të ardhurash të rregullta për jetesë. Përfundimisht, shtrohej si nevojë e domosdoshme ndërmarrja e një reforme të plotë për mbulimin e popullsisë me elementë të mbrojtjes sociale në tërësi dhe të sigurimeve shoqërore në veçanti. Sistemi i ri i pensioneve, filloi në vitin 2001 në harmoni me objektivat e Qeverisë së Kosovës, UNMIK-ut dhe bashkësisë ndërkombëtare për ndërtimin e një sistemi të përgjithshëm të mbrojtjes sociale të pranueshëm dhe efikas për zgjidhjen e problemeve ekonomiko-sociale e financiare të kohës, të plotësimit të kërkesave të politikës për hartimin dhe zbatimin e reformave stabilizuese dhe integruese të vendit.

Reforma në këtë fushë kishte synuar në një shkëputje nga sistemi i vjetër i pensioneve duke krijuar një skemë të re trishtyllështë të bazuar në përvojat e vendeve perëndimore dhe të vendeve në tranzicion. Me këtë model synohej të vendoseshin themelët e një sistemi të qëndrueshëm, i cili fillimisht nuk do të sillte përfitime të larta për pensionistët kosovarë. Sistemi i ri kishte për qëllim të ruajë skemën e sigurimeve shoqërore të Kosovës nga shumë probleme të cilat i ndeshin sot sistemet e pensioneve të shumë vende në zhvillim, të cilat e kanë të domosdoshme rritjen e normës së kontributeve për të kompensuar të drejtat e fituara dhe përkeqësimit të raporteve të numrit të të rinjve me të moshuarit si aktualisht ashtu edhe në të ardhmen.

Sistemi pensional në Kosovë, duke përfshirë atë kontributpagues, invalidor të punës dhe familjar, sot mund ta trajtojmë si sistemeve të sigurimeve sociale, ashtu siç është e rregulluar me legjislacionin e BE-së dhe standartet ndërkombëtare të ILO-s. Skemat pensionale të cilat janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti (ligji në fuqi), janë: pensioni bazik i moshës, pensioni kontributpagues i moshës, pensioni invalidor i punës, pensioni i paaftësisë së përhershme, pensioni familjar dhe pensioni i parakohshëm, i cili ligj është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në muajin maj 2014. Duke u nisur nga fakti se ky ligj rregullon një fushë e cila ka qenë e rregulluar në të kaluarën me një legjislacion të bazuar në sistem pensional PAYG dhe rregullore apo ligje të veçanta për kategori të pensionistëve,

zbatimi i tij në praktikë aktualisht po rezulton me shumë vështirësi dhe shumë pakënaqësi si nga pensionistët ashtu edhe nga zbatuesit e këtij ligji.

Pensionet kontributpaguese nuk lidhet me kontributet e paguara nga ana e pensionisteve, kontributet këto të paguara para vitit 1999 që janë akumuluar në një fond pensional, i cili është i përvetësuar nga Republika e Serbisë. Nga viti 2002, me ndryshimin e Sistemit Pensional në Kosovë, kontributet paguhen në shtyllën e dytë cila menaxhohet nga TRUSTI.

Çështje tjeter e cila është gjetur nga zbatimi i këtij ligji për pensionet kontributpaguese, është mungesa e përcaktimit të kritereve të qarta dhe të plota për sa i përket verifikimit të stazhit të punës. Edhe pse ligji në fuqi, nuk e ka përcaktuar në mënyrë shprehimore vitet e paguara të kontributeve nga ish të siguruar, ligji është thirrur në praktikat e legjislacionit të kaluar të cilat kanë qenë të aplikueshme para vitit 1999. Paqartësia e periudhave për vitet e kontributeve, mungesa e vërtetimit të fakteve të cilat shpeshherë janë pa fajin e pensionistëve, por si pasojë e luftës së zhvilluar në Kosovë në vitet e 90-ta, kanë rezultuar me mos njohjen e të drejtës për pension kontributpagues.

Si njëra ndër skemat e cila po konsiderohet mjaft e kushtueshme për Buxhetin e Kosovës, është skema e pensioneve bazike të moshës. Kjo skemë, siç njihet në teorinë dhe praktikën e sigurimeve sociale, është skemë jokontributive e financuar nga buxheti i shtetit. Në shumicën e vendeve të botës kjo skemë është e njohur si PENSION SOCIAL, e cila iu sigurohet qytetarëve të vendeve të cilët kanë të ardhura të ulëta jetese, apo thënë ndryshe, qytetarëve të moshuar të cilët jetojnë në varfëri apo kanë të ardhura të ulëta. Sot në botë janë përafërsisht 100 shtete të cilat i kanë të rregulluar dhe ofrojnë pensionin social. Kosova pothuajse është vendi i vetëm në rajon dhe Evropë (Holanda) e cila e ka dizajnuar dhe finançon këtë skemë që mbulon rreth 130.000 qytetarë të cilët janë shfrytëzues të këtij pensioni. Kriteret ndërkombëtare bazë për të përfituar këtë pension, janë shtetësia, të qenit banor i përhershëm, mosha dhe në disa raste edhe të ardhurat dhe të hyrat. Në ligjin në fuqi, kriteret të cilat janë përcaktuar, janë të bazuara në këto standarde ndërkombëtare duke përashtuar të ardhurat dhe të hyrat e llogaritshme. Neni 7 i Ligjit nr.04/L-131 per skemat pensoinale te fianncuara nga shteti, percakton kriteret kryesore sic janë shtetësia e Kosovës, të qenit banor i përhershëm dhe mosha mbi 65 vjet. Kriteri për të qenë banor i përhershëm i Kosovës, sot po konsiderohet si një ndër faktorët më problematikë. Ky kriter nuk është duke u përfillur sa duhet nga një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit e për të cilën, me ligjet e aplikueshme në Kosovë të qenit banor i përhershëm i Kosovës lejon shumë hapësirë për keqpërdorime.

Mungesa e respektimit të ligjit si dhe shfrytëzimi i paqartësisë ligjore nga qytetarët kosovar ka rezultuar me keqpërdorimin e pensioneve bazike të moshës. Bazuar në këto kriter, konsiderohet se çdo i moshuar në Kosovë, është duke marrë pension bazik të moshës, pa marrë parasysh se jeton në Kosovë apo jo dhe pa marre parasysh, se a ka te ardhura tjera apo jo. Kjo çështje sidomos lidhet me qytetarët e Kosovës të cilët janë shtetas të Kosovës por nuk janë banorë të përhershëm të saj, përkatësisht jetojnë jashtë vendit. Kriteret e buta të cilat janë përcaktuar me kornizën ligjore të fushës së

pensioneve, po mundësojnë që pensionistët të cilët jetojnë jashtë vendit, kanë mundësi që të vijnë së paku një herë në vit në Kosovë dhe të marrin në mënyrë retroaktive të gjitha pensionet bazike të moshës. Kjo çështje ndërlidhet edhe me rregullat për procedurat e lajmërimit të pensionistëve në çdo gjashtë muaj për të vërtetuar se a janë në jetë si dhe me procedurat e suspendimit nga pagesa për plus gjashtë muaj të tjerë, në rastet kur nuk e respektojnë afatin 6 mujor të lajmërimit. Kjo politikë e zbatuar deri më tanj, ka treguar se në Kosovë, e drejta për të përfituar nga kjo skemë e pensioneve po keqpërdoret nga pensionistët të cilët jetojnë jashtë vendit ndërsa deklarojnë se janë banorë të pérhershëm të Kosovës.

Çështje tjeter e cila ndërlidhet me skemën e pensioneve bazike të moshës dhe skemat e tjera pensionale të aplikueshme, është e drejta e marries së këtij pensioni pas arritjes së moshës 5 vjeçare dhe përfitimit apo pensionit tjeter nga ndonjë skeme tjeter e veçantë, si p.sh. pensioni i marrë nga Trusti Pensional pas arritjes së moshës së pensionimit, pensioni për invalidët e luftës, pensioni i fituar jashtë shtetit për qytetarët kosovar të cilët kanë punuar jashtë Kosovës si dhe ne rastet kur pensionistët janë në marrëdhënie pune jo të rregullt apo si të vetëpunësuar. Kostoja e mbështetur sipas përfitimeve të ndryshme të pensioneve të dhëna sipas ligjit (mosha 65, aftësisë së kufizuar, invalidëve, veteranëve apo skemë të tjera të veçanta) nuk është i qëndrueshëm në afat të gjatë nga ana e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës.)

Problem tjeter i shfaqur gjatë zbatimit të këtij ligji, është edhe skema e pensioneve të parakohshme për të punësuarit e Trepçës dhe minierave tjera të Kosovës. Në bazë të kësaj skeme, të punësuarit e minierave te Trepçës dhe minierave tjera të Kosovës, duhet të plotësojnë edhe njërin prej kritereve të ligjit i cili ka të bëjë me periudhën e ndërprerjes së marrëdhënie së punës pa fajin e të punësuarit. Kjo periudhe në ligjin në fuqi, nuk është konkretizuar dhe sraquar sa duhet. Neni 10 paragrafi 2.6 po ashtu po konsiderohet si një problem tejet serioz, si nga zbatuesit ashtu edhe nga vet të punësuarit të këtyre minierave, të cilat kanë aplikuar për pension të parakohshëm. Kjo dispozitë është konsideruar si një pengesë serioze nga zbatuesit, si dhe punonjësve të minierave të tilla, që kanë aplikuar për pensionim të parakohshëm, por që kanë dokumentacion joadekuat ose prova për të plotësuar kualifikimin.

Lidhur me skemën e pensioneve të paaftësisë së pérhershme, nga zbatuesit e kësaj skeme si dhe nga shoqatat të cilat përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara, në adresë të MPMS-së, janë pranuar vërejte të shumta për konceptin e këtij pensioni si dhe për procedurat e riaplikimit për një, tre dhe pesë vite. Kjo çështje është ngritur në debate të shumta në lidhje, për shembull, shkalla apo "Përherëshmëria" e aftësisë së kufizuar dhe aftësinë për të vazhduar fituar të ardhura, dhe domosdoshmërinë e rivlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Çështje tjeter për të cilat janë identifikuar probleme dhe pengesa gjatë zbatimit të këtij ligji janë edhe procedurat administrative, përkatësisht vendosja e afateve të stërgjatura si për aplikim dhe ankimim, pastaj procedurat për lidhjen e marrëveshjeve me Bankat Komerciale të Kosovës për shpërndarjen e pagesave të pensioneve, çështjet lidhur me

procedurat e lajmërimit dhe suspendimit nga pagesa dhe çështjet e kthimit të pagesave në rastet kur keqpërdoren pensionet.

### *Politikat aktuale*

Politikat pensionale në vendin tonë, në përgjithësi konsiderohen se janë të hartuara dhe dizajnuara sipas praktikave të mira të ndryshimeve që po ndodhin nëpër vende të ndryshme të botës. Kosova, pas vitit 1999 ka instaluar sistemin e ri pensional krahas ish sistemit të ashtuquajtur PAYG i aplikuar para vitit 1999. Reformat pensionale, kanë filluar saktësisht nga viti 2002 ku janë ndarë sistemet pensionale në tri shtylla ashtu siç është praktika e shumë vendeve të botës. Sistemi aktual bazohet në një ndarje të qartë të roleve, i cili është i organizuar në tri shtylla;

- Shtylla e parë duke siguruar një mbulim minimal të grupit të caktuar të mallrave të shportës, shërbën njëherazi edhe si një element garantues për të luftuar varférinë.
- Shtylla e dyte shërbën si mekanizëm kryesor për kursime pensionale në të mirë të plotësimit të të ardhurave dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së moshës së tretë.
- Shtylla e tretë, e cila është skemë vullnetare krijon hapësira që kundrejt kontributeve shtesë të arrihen përfitimi më të larta nga ato të garantuara nga dy shtyllat e para.

Shtylla e parë - duke qenë tërësisht e financuar nga të ardhurat e përgjithshme në buxhetin e Kosovës ka mënyjanuar taksat e larta mbi pagë, si rrjedhojë ul koston e punës dhe nxit punësimin.. Megjithëse konsiderohet unik për reduktimin e varfërisë për moshën e tretë, përsëri për shkak të të ardhurave mujore të ulëta, ndikimi i sistemit te pensioneve në ketë çështje, mbetet i reduktuar. Aktualisht familjet që kanë mbi 50 për qind të anëtarëve të tyre të moshuar kanë rreth 62 për qind probabilitet për të qenë të varfér, që është rrezik shumë më i lartë se sa për të gjitha kategoritë e tjera të shoqërisë. Prej fillimit të vitit 2008 zbatohet një skemë e pensioneve favorizuese që diferencohen në vlerë nga pensionet bazë dhe që adresohet për kontribuuesit e sistemin të vjetër të mëparshëm. Megjithëse kjo skeme konsiderohet e arsyeshme sepse mbështetet në parimin e karrierës kontributive ajo nuk mund të vlerësohet e pranueshme nga të gjithë përfituesit, sepse përfitimi mëjor shtesë është i barabarte për të gjithë. Nga skema e përfitimeve të favorizuara janë përjashtuar personat që nuk mund të vërtetojnë me dokumente individuale periudhën kontributive në sistemin e vjetër të pensioneve. Sistemi nuk ka garantuar mbështetje financiare për personat që bëhen pjesërisht të paaftë për punë për shkak të një sëmundjeje, sepse skema e pensioneve invalidore siguron përfitimi vetëm në rastet e paaftësisë së plotë për punë. Kjo mund të rritë presionin dhe pretendimet ndaj komisioneve mjekësore për vlerësimë jo të drejta të gjendjes shëndetësore dhe aftësisë për punë dhe që në shumë raste shoqërohen me abuzime të fondeve publike.

Shtylla e dytë - e sistemit të detyrueshëm mbalon të punësuarit dhe persona e tjërë ekonomikisht aktiv me një pension mëjor shtesë mbi pensionin bazë në kthim të kontributive të derdhura dhe fitimeve të siguruara nga investimi i tyre. Skema është ndërtuar mbi bazën e kontributive të përcaktuara, ndërsa pensioni varet nga shuma e kursimeve individuale dhe përfitimeve nga investimet e fondeve. Krijimi i fondeve

pensionale me kontributet të detyrueshme dhe vullnetare është bazuar në kërkesa të qarta mbi transparencën dhe mbikëqyrjen nga qeveria dhe institucionet e specializuara. Sistemi tashmë zbatohet duke u mbështetur në arkëtime të qëndrueshme, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave individuale, informatizimin e proceseve dhe të komunikimit dhe modernizimin e proceseve të tjera të informimit publik. Duke u mbështetur në mënyrën e ndërtimit të tij, sistemi siguron një qëndrueshmëri fiskale afatgjate duke lënë hapësirë për të tjera programe sociale, bazuar në nevojat e popullsisë. Në vitin 2008 sistemi i pensioneve mbi bazë kursimesh është përballur me rënien e ndjeshme të vlerës së aksioneve duke konsumuar jo vetëm fitimet nga investimet në periudhat e mëparshme, por duke prekur edhe derdhjet kontributive. Llogaritë individuale të të gjithë kontribuuesve kanë pësuar një rënie të ndjeshme, ndërkoq që preken direkt përfituesit aktuale, të cilët kanë marrë ose do të marrin më pak pensione se më parë. Bordi i Trustit ka vendosur që personave që janë pensionuar dhe janë i kanë térhequr kursimet e veta në shumë më të vogël se sa ajo që kanë kontribuar, tua kompensojë këtë shumë. Kjo nuk mund të quhet një masë e drejtë dhe e qëndrueshme po të kemi parasysh përcaktimin ligjor se Trusti vepron si një institucion juridik i veçantë jofitimprurës. Në statutin e Trustit parimisht është përcaktuar së kontributet pensionale të kursyera nga qytetarët e Kosovës gjatë marrëdhënies së punës ruhen nëpër llogari individuale të kontribuuesit. Administrimi i këtyre llogarive individuale është përgjegjësi ligjore e Trustit, ndërsa paratë mbesin pronë vetjake e kontribuuesit. Edhe pse janë pronë private, destinacioni i përdorimit të këtyre kursimeve është specifisht i përcaktuar – ato mund të përdoren vetëm për pension. Mbulimi i popullsisë me pensione bazuar në kursime do të vazhdojë të mbetet i ulët për shkak të nivelit të lartë të papunësisë si dhe nga shkalla e lartë e punësimit joformal. Këto dy faktorë të rendësishëm përbëjnë edhe një sfidë të madhe për zhvillimet ekonomike të ardhshme dhe për sistemin e sigurimeve shoqërore në veçanti.

Shtylla e tretë - e sistemit vullnetar të sigurimeve ka një veprimtari të kufizuar ndërkoq që nuk janë zhvilluar skemat e pensioneve suplementare të korporatave megjithëse ekziston legjislacioni. Ky sistem ofron pensione suplementare e individuale që financohen nga kontributet vullnetare të individuve, si nga kontributet shtesë të punëdhënësit për punëtorët e vet ashtu edhe nga fitimet e realizuara nga investimi i këtyre kursimeve. Banka Qendrore licencon dhe vendos rregullat për skemën e shtyllës së tretë si dhe për institucionet e administrimit të tyre.

Departamenti i Pensioneve është përgjegjës për akordimin dhe administrimin e pensioneve individuale bazë dhe të paftësisë, evidentimin e sistemit të pagesave, buxhetimin dhe evidentimin e shpenzimeve. Ndërsa përcaktimi i aftësisë për punë për personat që aplikojnë për të përfituar nga skema pensionale e personave me aftësi të kufizuara bëhet nga komisionet mjekësore të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ky departament, propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve të politikave/strategjive të sistemit pensional në Republikën e Kosovës për të gjitha skemat pensionale të menaxhuara dhe financuara nga shteti. Në të njëjtën kohë menaxhon me kohë pagesat e pensioneve të pensionistëve, menaxhon dhe mirëmban regjistrat dhe statistikat për pagesat e pensioneve dhe njëkohësisht siguron zbatimin e procedurave për realizimin e të drejtave për pensione

për qytetarët e Kosovës që kanë punuar jashtë vendit. Gjithashtu, propozon dhe iniciacion procedurat për arritjen e marrëveshjeve bilaterale nga fusha e sigurimeve sociale. Departamenti mirëmban dokumentacionin për të gjitha mjetet e shpenzuara lidhur me shpërndarjen e pensioneve, monitoron statusin e personave që janë përfitues të pensioneve dhe bën raporte të rregullta periodike nga fusha e pensioneve.

Struktura organizative e Departamentit të Pensioneve, është:

1. Divizioni për Politika Pensionale,
2. Divizioni i Skemave Pensionale,
3. Divizioni i Pensioneve të Jashtme,
4. Divizioni për Monitorimin e Zyrave të Pensioneve, dhe
5. Divizioni i Komisionevë Mjekësore.

Në kuadër të Departamentit të Pensioneve janë 7 Zyra Pensionale, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, nëpër çdo qytet.

Trusti është përcaktuar të administrojë kontributet e detyrueshme pensionale të të punësuarve aktualë në Kosovë. Ai është institucion i themeluar në vitin 2002, vepron si entitet juridik i veçantë dhe jo fitimprurës. Kontributet e mbledhura në llogari janë pronë individuale e kontribuuesve dhe nuk mund të përdoren nga qeveria për asnjë lloj shpenzimi. Investimi dhe riinvestimi i kursimeve pensionale realizohet nëpërmjet një menaxhues të mjeteve financiare, i cili përcaktohet nga Bordi Administrativ.

Shtylla e tretë menaxhohet nga sektori privat ku mbahen kursimet jo obligative të qytetarëve të Kosovës të cilët janë në marrëdhënie pune. Kontributet vullnetare janë kursime suplementare apo shtesë.

#### *Ligjet dhe aktet nënligjore*

Ligji bazë i fushës së pensioneve të shtyllës së parë, është Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky ligj rregullon skemat e pensioneve të cilat financohen nga shtetit, siç janë: pensioni bazik i moshës, pensioni kontributpagues, pensioni familjar, pensioni i paaftësisë për punë, pensioni invalidor i punës dhe pensioni i parakohshëm. Përveç ligjeve në fuqi, Departamenti i Pensioneve, ka filluar tashmë edhe negocimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërshtetërore për çështjet e pensioneve. Këto marrëveshje, konsiderohen si prioritare për Qeverinë e Kosovës, për arsy se shumë qytetarë kosovar që jetojnë jashtë vendit, nuk do të mund të realizojnë të drejtën e tyre në pension të pleqërisë/kontributpagues në Kosovë, pa arritjen e këtyre marrëveshjeve ndërshtetërore. Departamenti i pensioneve përmes zyrave pensionale të saj, menaxhon dhe zbaton edhe shumë ligje tjera për disa kategori të qytetarëve të cilat iu njihet e drejta në pensione të veçanta. Si ligje të veçanta në fushën e pensioneve janë pensionet për kategoritë e dala nga lufta, siç janë pensionet për familjet e dëshmorëve, pensionet për invalidët e luftës, pensionet për viktimat civile të luftës dhe pensionet për gratë e dhunuara gjatë luftës. Këto pensione janë të rregulluara me Ligjin Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimate civile dhe familjeve të tyre dhe i

amendmentuar. Përveç këtyre skemave, Kosova ka nxjerrë ligj të veçantë edhe për veteranët e luftës së UÇK-së, Ligjin nr. 04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sipas këtij ligji, veteranët kanë të drejtë në pension vetëm nëse nuk janë në marrëdhënie pune. Lidhur me përfitimet me skemat e tjera pensionale të finançuara nga shteti, ky ligj në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se veterani, nuk ka të drejtë që të jetë përfitues i dy e më shumë pensioneve të cilat paguhen nga buxhetit të shtetit. Si ligje të veçanta njihen edhe Ligji Nr. 03/L-100 për ish pjesëtarët e Trupave të Mbrojtjes të Kosovës dhe Ligji Nr. 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Kosovës. Sipas këtyre ligjeve, qytetarëve të Kosovës, iu njihet e drejta në pension të TMK-së dhe pension të FSK-së sipas kushteve dhe kritereve të këtyre ligjeve. Edhe për këtë kategori, ligji ka përcaktuar se ish pjesëtarë i TMK-së dhe FSK-së, nuk ka të drejtë që jetë përfitues i dy e më shumë pensioneve të cilat paguhen nga buxheti i shtetit. Përveç pensioneve të finançuara nga shteti, qytetarët e Kosovës përfitojnë edhe nga skemat e tjera të zbatueshme nga MPMS-ja, siç janë skema e ndihmës sociale, kompensimi për personat e verbër dhe kompensimi për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto skema janë të rregulluara me Ligjin Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë dhe i amendmentuar, Ligji Nr. 04/L-092 për personat e verbër dhe Ligji Nr. 03/L-022 për përkrahje materiale të familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara. Ndërlidhja e pensionit bazik të moshës dhe skemës së ndihmës sociale konsiston në atë se këto dy skema kanë qëllime sociale por të cilat dallohen në kriteret e forta dhe të buta të përcaktuara në këto ligje. Skema e ndihmës sociale, konsiston me një sërë kriteresh të forta për të përfituar të drejtën në ndihmë sociale, ndërsa skema e pensionit bazik të moshës konsiston me kriteret të buta të përfitimit. Përderisa këto dy skema kanë qëllime të njëjtë sociale, nga këndvështrimi i MPMS-së si hartuese dhe monitoruese e këtyre dy ligjeve, është ardhur në përfundim se këto dy skema, duhen të harmonizohen sipas qëllimit të tyre social.

Shtylla e dytë e sistemit pensional rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës dhe i amendmentuar. Ky sistem, është komplet i ndarë nga shtylla e parë e sistemit pensional. Ky ligj, përkatësisht shtylla e dytë, menaxhohet dhe administrohet nga Fondi Pensional i Kosovës. Kjo shtyllë bazohet në kursimet individuale të detyrueshme. Sipas këtij ligji, të gjithë të punësuarit nga vitit 2002, janë të detyruar të ndajnë kursime individuale nga pagat e tyre me shumën prej 5%. Pas arritjes së moshës së pensionimit, personat të cilët plotësojnë kriteret, kanë të drejtë të marrin pensionin sipas kontributeve të ndara gjatë punës nga Fondin Pensional.

#### *Vlerësimet shtesë të politkës aktuale*

Ligji në fuqi për skemat pensionale, ka përcaktuar zbatimin e dy skemave të reja pensionale, skema e pensioneve invalidore e punës dhe skema e pensioneve familjare, të cilat ishin planifikuar të zbatohen nga 1 janari 2015. Për arsyet e mungesës së mjeteve buxhetore të MPMS-së, deri më tani nuk ka filluar t'i zbatojë ato. Këto dy skema, konsiderohen se janë skema të cila përherë të parë do të instalohen në Kosovë pas vitit 1999. Me zbatimin e këtyre dy skemave, Kosova, do të jetë një hap përpëra drejt përmbytjes dhe mbulimit të fushave në kuadër të sistemit të sigurimeve sociale. Gjithashtu, do të krijohen mundësi për fillimin e negocimit të plotë të marrëveshjeve

bilaterale për sigurimet sociale me shtetet për të cilat vendi ynë ka interesim për nënshkrimin e marrëveshjeve.

Për zbatimin e plotë të skemave tjera pensionale, ligji ka përcaktuar edhe nxjerrjen e akteve nënligjore. Kështu, në fund të vitit 2015, MPMS-ja ka nxjerrë katër udhëzime administrative, siç janë: Udhëzimi Administrativ nr. 05/2015 për procedurat e lajmërimit, suspendimit nga pagesa dhe kthimit të mjeteve në rastet e keqpërdorimit të pensioneve, Udhëzimi Administrativ nr. 06/2016 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së pérhershme, Udhëzimin Administrativ nr. 07/2015 për procedurat e aplikimit dhe ankimit në skemat pensionale të finançuara nga shteti, dhe Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesave të kontributeve - stazhit pensional. Lidhur me këtë të fundit, Qeveria e Kosovës, ka marrë vendim pë. njohjen e stazhit të punës për të gjithë pensionistët të cilët në mungesë të dëshmive, do t'i njohë në mënyrë automatike, përvojën e punës e cila është e barasvlershme me 25 vjet përvojë pune. Ndërsa për kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, Qeveria po ashtu do të marrë vendim për rritje të pensioneve, pas verifikimit të plotë të përfituesve aktuale sipas dëshmive përkatëse dhe rishikimi i kufizimeve buxhetore të Kosovës. Aktualisht, procesi i aplikimit për njohjen e përvojës së punës, ka filluar nga data 18 janar 2016 dhe do të zgjasë deri më 31 mars 2016. Pas këtij procesi, MPMS-ja, do të verifikojë numrin e saktë të përfituesve të cilët kanë dëshmuar se kanë kryer edukimin, si: shkollën e mesme, shkollën e lartë dhe fakultetin.

#### *Përvoja në shtetet e tjera*

Në kuadër të këtij kapitulli, japim një pasqyrë të shkurtër lidhur me funksionimin e sistemeve pensionale në përgjithësi.

Fillimisht duhet të ceket se ekzistojnë disa referenca përmes të cilave është munduar të krijohen disa standarde minimale lidhur me sigurimet sociale. Në këtë drejtim duhet të përmendet Konventa e ILO-s, e cila përveç që shërben si bazë e dizajnimit të sigurimeve sociale, ajo jep një përkufizim të sigurimeve sociale për nëntë fusha sa i përban kjo konvente, si dhe përban minimumin e standardeve për secilën fushë. Ashtu siç u cek edhe më lartë Konventa e ILO-s nr. 102, përfshin nëntë fusha të cilat kanë të bëjnë me: qasjen në kujdesin shëndetësor; sëmundjet; papunësinë; përfitimin e pleqërisë; lëndimin në punë; pensionin familjar; përfitimin e lehonisë; pensionin invalidor si dhe përfitimet e mbijetesës.<sup>1</sup>

Megjithatë ekzistojnë tipe dhe modele të ndryshme të rregullimit dhe organizimit të sigurimit pensional, ku rrjedhimisht, sistemi pensional është ndërtuar nga secili shtet veç e veç.

#### Austria

Sistemi i pensioneve në Austri ka ndryshuar vazhdimisht gjatë dekadave të fundit. Hapi i parë ishte Ligji "pensionkassen" që rregullonte përfitimet e pensioneve në bazë të planeve të reja dhe që hyri në fuqi në vitin 1990. U përcaktua ligji që harmonizonte

<sup>1</sup> Konventa e ILO-s No 102

moshën për daljen në pension për burrat dhe gratë - 65 vjeç. Në vitin 2003 ndodhën ndryshime të mëdha në sistemin e sigurimeve sociale të cilat u aprovuan nga Parlamenti Austriak: pensioni i parakohshëm do të shfuqizohej, dhe shuma vjetore e menduar e kontributeve për pension do të reduktohej. Ndryshimet ndodhen edhe në vitin 2005 me qëllim të harmonizimit të skemave të ndryshme të pensionimit.

Aktualisht pensionet bazike të moshës jepen nga mosha 65 vjeçare për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Gradualisht mosha e pensionimit për gratë do të barazohet me moshën e pensionimit për burrat brenda viteve 2024-2033. Për të marrë ligjërisht statusin e pensionistit duhet të përbushet periudha kualifikuese, që mund të jetë 180 muaj (15 vite) kontribuite.

Në Austri sistemi pensional është i organizuar në 3 shtylla kryesore. Në shtyllën e parë bën pjesë sistemi pensional ligjor (shtetëror) apo i detyrueshëm, e që praktikohet pothuajse në tërë Evropën. Fondet pensionale në këtë sistem financohen nga kontributet e punëmarrësit dhe të punëdhënësít.

Karakteristikë e veçantë e shtyllës së parë është se fondet e grumbulluara nga popullsia aktive shfrytëzohen në të njëjtën kohë për financimin e pensioneve për popullatën pasive, siç njihet ndryshe "solidariteti mes gjeneratave", që nënkupton se këto mjete nuk dedikohen për investime në tregun e kapitalit.

Shtylla e dytë ka të bëjë me sistemin pensional të ndërmarrësisë. Në këtë shtyllë financimi i fondeve bëhet kryesisht nga punëdhënësi dhe mjetet e grumbulluara nga këto fonde zakonisht janë të dedikuara për investime në tregun e kapitalit. Pasi që mjetet e grumbulluara të këtyre fondeve nuk dedikohen për financimin e pensioneve aktuale, por për ato të ardhshme, del që çdo person aktiv kontribuon në financimin e pensionit të tij në të ardhmen.

Shtylla e tretë ka të bëjë me pensionet private. Financimi i këtyre fondeve bëhet nga personat që në mënyrë individuale vendosin për të financuar pensionet e tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se mjetet e dedikuara në këto fonde janë të liruara nga tatimet shtetërore.

Sistemi pensional austriak është kryesisht i orientuar nga ai shtetëror (Shtylla e parë) dhe është i një rëndësie të veçantë pothuajse për tërë popullatën pasive (pensionistët) dhe njëherësh i vetmi burim i të ardhurave të tyre. Pra, 80% e pensioneve aktuale paguhen nga ky fond. Shtylla e dytë, ajo e ndërmarrësisë dhe e treta, ajo private, janë në zhvillim e sipër dhe nuk paraqesin ndonjë ndihmesë të veçantë për financimin e fondeve pensionale.

Përparësia e vetme e sistemit austriak të pensioneve është se mjetet e grumbulluara nuk janë të dedikuara për investim në tregun e kapitalit, gjë që mund të kuptohet se fondet pensionale austriake nuk janë shumë të varura nga zhvillimet e tregut të kapitalit, përkatësisht nga normat e interesit, apo nga kriza e tregjeve financiare, siç ishte rasti me krizën globale financiare.

Ndërsa, mangësia e këtij sistemi është se ky sistem pensional është shumë i varur nga zhvillimet demografike në njérën anë, kurse pensionet e ardhshme të gjeneratës së tashme aktive, në anën tjetër, janë shumë të varura nga produktiviteti dhe aftësia financiare e gjeneratës së ardhshme. Çdo ngritje e shkallës së pensionit në njérën anë dhe ulja e normës së kontributeve, në anën tjetër, të kësaj gjenerate ngarkon financiarisht gjeneratën e ardhshme.

### Zvicra

Si në sistemin austriak, po ashtu edhe në atë zviceran është i njohur koncepti: modeli trishtyllësh), i shpjeguar më lartë. Përkundër sistemit austriak, sistemi pensional zviceran është i orientuar sa në sistemin shtetëror (shtylla e parë), po aq edhe në atë të ndërmarrësisë (shtylla e dytë) dhe sistemin privat (shtylla e tretë). Sistemi pensional shtetëror nuk e tejkalon shifrën prej 50% të pjesëmarrjes së tërësishine në sistemin pensional zviceran. Pensionet e ndërmarrësisë përbëjnë 35%, kurse ai privat 15% të totalit të pensioneve. Vlen të theksohet se "Shtylla e dytë" e sistemit pensional zviceran është e obligueshme.

Punëdhënësi është i detyruar të paguajë kontibutet pensionale për punëmarrësit e tij që janë të moshës mbi 25 vjet dhe që kanë pagën vjetore më të lartë se 24.360 CHF. Kjo shtyllë paraqet dallimin esencial të sistemit pensional zviceran nga ai austriak, ngaqë shtylla e dytë në Austri nuk është e obligueshme. Edhe sistemi zviceran njeh si kontributdhënës personat të cilët janë të papunë dhe marrin ndihmë, përkujdesjen ndaj fëmijëve sa i përket shkallës së parë dhe me kushte të caktuara. Zvicra po ashtu ofron bonusë në pensione për gra dhe burra të cilët kujdesen për të persona të afërt.

Sistemi pensional zviceran të vetmen mangësi që ka është se mjetet e grumbulluara nga fondet pensionale të ndërmarrësisë, dedikohen kryesisht për investime në tregun e kapitalit dhe nga kjo del se janë shumë të varura prej zhvillimeve të tregut të kapitalit. Rasti më i freskët është ai i vitit 2008, ku për shkak të krizës financiare globale fondi pensional invalidor në Zvicër regjistroi një humbje prej 14 miliardë frangash zvicerane.

Por, në anën tjetër përparësítë e sistemit zviceran kundrejt atij austriak janë të shumta. E para ka të bëjë me zhvillimin e njëjtë të nënsistemeve, si ai shtetëror, i ndërmarrësisë dhe ai privat, çka gjenerata e tashme aktive nuk është shumë e varur nga produktiviteti dhe aftësia financiare e gjeneratës së ardhshme, dhe po ashtu gjeneratat e ardhshme nuk ngarkohen financiarisht për shkak të ngritjes së pensioneve të gjeneratës së tashme.

E dyta, sistemi zviceran i pensioneve është i organizuar në atë formë që klasa e pasur merr pjesë më shumë në financimin e fondeve në krahasim me klasën e mesme apo klasën e varfér. Këtu baza mbi të cilën llogariten kontibutet nuk është e përkufizuar "sa më të larta janë të ardhurat, aq më të larta janë kontibutet".

### Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar ka një popullsi prej 70 milion banorësh dhe fuqi punëtore prej 29 milionë njerëzve. Rreth 23 milionë prej tyre janë të punësuar në sektorin privat dhe 6 milion në sektorin publik. Numri i pensionistëve në Britani të Madhe është 12 milion,

ndërsa rreth 1.4 milion punëtorë janë pensionistë të moshës. Pensionet në Mbretërinë e Bashkuar janë të organizuara në tre divizione të mëdha dhe 7 nën-ndarje.

#### Pensionet e Shtetit

- Pensioni Bazë i Shtetit
- Pension i Dytë i Shtetit (S2P)

#### Pensionet e Punës/Profesionale

- Pensioni i përfitimeve të përcaktuara
- Pensioni i kontributeve të përcaktuara

#### Pensionet Personale/Individuale

- Pensionet e Palëve
- Pensioni Personal për Grup
- Pensioni Personal nga Vetë-investuar

Sistemi i pensioneve në Mbretërinë e Bashkuar mund të konsiderohet se është i organizuar në tre shtylla apo nivele, të cilat kanë për objektivë:

- Pensioni shtetëror - ofrohet nga shteti dhe përbëhet nga një nivel bazë i pensionit që bazohet në vitet kualifikuese dhe kontributet e Sigurimeve Kombëtare. Ata që nuk kualifikohen për një pension bazë të shtetit, marrin një pension jo kontribuuves.
- Pensioni i punës- ofrohet nga shteti dhe ka për qëllim të ofrojë të ardhurat e pensionit që është e lidhur më ngushtë me të ardhurat e punonjësve, të cilat financohen bashkërisht nga punëdhënësi dhe të punësuarit.
- Pensioni personal – aranzhohet dhe organizohet për të kontribuar nga individ me ofrues nga kompanitë e sigurimit.

Pensionet shtetërore hyjnë në grupin e shtyllës I të dhënies se pensioneve, të cilat ofrohen nga shteti dhe përbëhen nga një nivel bazë i sigurimit të pensioneve, duke siguruar një nivel minimal të të ardhurave të daljes në pension. Në kuadër të këtij grupei janë të përfshira: *Pensioni Bazë i Shtetit*, i cili vepron mbi bazën "PAYG", përmes Sigurimeve Kombëtare dhe tatimi i përgjithshëm dhe *Kredit Pensioni*, i cili financohet nga tatimet e përgjithshme. Mosha e pensionit shtetëror nuk është e njëjtë si e moshës së pensionit. Mosha e pensionimit është kur ju zgjidhni të dilni në pension, por mund të vazhdoni të punoni pas moshës së pensionimit shtetëror.

*Pension Bazë i Shtetit* - (PBSH) është një pension kontribuuves në kuptimin që shuma finale e paguar për një individ varet nga numri i viteve të kontributeve të Sigurimeve Kombëtare të bëra para se të arrijnë moshën e pensionimit. Pensioni Bazë i Shtetit varet nga data e lindjes së një individi, e cila është aktualisht 65 vjeç për burrat, ndërsa për gratë është rreth  $62\frac{1}{2}$  dhe është në rritje, për t'u barazuar me meshkujt në vitin 2018 në moshën 65 vjeçare. Ekzistojnë pesë kategori të pensioneve shtetërore themelore (PBSH) të siguruara nga shteti:

- Kategoria A-është e bazuar në kontributet e individit;
- Kategoria B-është e bazuar në vitet kualifikuese bashkëshortit ose partnerit civil;
- Kategoria C-është jo-kontribuuuese dhe është e pagueshme për të vejat e njerëzve që ishin mbi moshën 65 nga 5 korrik 1948;
- Kategoria D-është jo kontribuuuese dhe është e pagueshme për njerëzit mbi moshën 80 vjeç, por duhet të plotësojë disa kushte të qëndrimit dhe dështojnë të kualifikohen për kategorinë A ose B;
- Mosha Shtesë-është jo kontribuuuese dhe është e pagueshme për të gjithë përfituesit e pensionet shtetërore të moshës 80 vjeç ose më lartë.

Kategoria A- pensioni është kontribuuues dhe është i bazuar në historinë e kontributeve të individit, pastaj vitet kualifikuese të një bashkëshorti apo ish-bashkëshorti (të ndara përmes ose kur humbin të afërmit apo ndarje) mund të zëvendësohen për të siguruar një PBSH më të lartë. Për ata që kanë arritur moshën e pensionit shtetëror nga 6 prilli 2010, numri i viteve të nevojshme për t'u kualifikuar për një kategori të plotë një pension është reduktuar nga 44 vjet për një burrë dhe 39 vjet për një grua deri në 30 vjet kualifikuese njësoj për burrat dhe gratë. Një person i cili ka më pak se 30 vjet kualifikuese do të ketë të drejtë për një pjesë të PBSH plotë për çdo vit kualifikuese.

Kategoria B- pensioni është kontribuuues dhe bazohet vetëm në një bashkëshort apo partneri civil të viteve kualifikuese dhe të ardhurat. Më parë ajo ishte vetëm për t'u paguar për gratë e martuara, të cilat kanë mbetur të veja, por nga 6 prilli 2010 të dy burrat dhe gratë mund të kërkonin PBSH.

Kategoria C- pensionet janë të pagueshme në masën 60% të PBSH e plotë për burra të moshës mbi 65 vjeç më 5 korrik 1948 ose grave të veja të njerëzve të cilët ishin të moshës mbi 65 në korrik 1948.

Kategoria D-pension jo kontribuuues, ekuivalent me të rritur të cilët janë të moshës 80 vjeç apo me lartë dhe kanë qenë rezident në Mbretërinë e Bashkuar për të paktën 10 vjet gjatë 20 viteve të fundit.

Mosha Shtesë- është jo kontribuuuese dhe është e pagueshme për të gjithë përfituesit e pensionet shtetërore të moshës 80 vjeç ose më lartë.

**Pensioni Kreditor-** ka dy komponentë: Kredia Garantuese , e cila aktualisht paguhet nga mosha  $62\frac{1}{2}$  , dhe Kursimet Kreditore , të cilat paguhën nga mosha 65. Prej vitit 2010 mosha minimale për marrjen e Kredive Garantuese është në rritje.

**Kredia Garantuese**-është mjet përfitimi kryesor - i testuar, e cila paguhet aktualisht për ata të moshës  $62\frac{1}{2}$  dhe më lart. Njerëzit (ose familje) bëhen të ligjshëm për KG nëse mjete të tjera (burimet e të ardhurave) nuk arrijnë një nivel të caktuar. KG ofrojnë një rrjet sigurie për një nivel minimal të të ardhurave. KG është e paguar me një bazë "Njësie përfitim" që do të thotë se ajo i paguhet një personi të vetëm ose një çift, në kushtet që të ardhurat nga burime të tjera janë nën nivelin e plotë dhe me kusht që çdo orë që ka

punuar dhe kursimet mbahen janë nën kufijve të përcaktuar. KG është rishpërndarës ajo paguhet nga tatimet e tanishme, të cilat rrisin të ardhurat e një individi, ndërsa pagesat KG janë bërë vetëm për ata që janë me të ardhura të ulëta.

*Kursimet Kreditore-* synojnë të sigurojë ata të cilët kanë bërë depozita private për kohën e daljes në pension ose kanë bërë përgatitjet më të madhe të Pensionit Bazë të Shtetit. Shuma maksimale e pagueshme sipas Kursimeve Kreditore është 14,82 £ në javë për një person të vetëm dhe 17,43 £ në javë për një çift nga prilli 2015.

### Letonia

Reforma e parë e sistemit të mbrojtjes pensionale është ndërmarrë në vitin 1990. Fondi shtetëror i siqurimeve shoqërore u nda nga buxheti i shtetit dhe administrohej nga këshilli trepalësh: përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve, nga sindikatat e punëtorëve dhe nga qeveria. Fondi i sigurimeve shoqërore financohet nga kontributi i punëdhënësve në shumë prej 30% të fondit të pagave dhe 1% nga kontributi i punëtorëve. Edhe pse këto norma nuk ishin të larta buxheti i shtetit ishte deficitar. Në janar të vitit 1995 mesatarja e moshës për dalje në pension ka qenë me 35 vjet përvjë pune, ose 50% e mesatares së të ardhurave neto (pensionet nuk janë tatimuar). Në janar të vitit 1995, qeveria ka paraqitë në parlament koncepte të reja për reforma të sistemit pensional, të ashtuquajtur sistemi tre rreshtorë:

- Shtylla e parë do të modifikohet si sistem pay-as-you -go, me një lidhje të fortë me kontributet, si dhe me një pension minimal që të mbrojë (sigurojë) të varfrit;
- Shtylla e dytë, me karakter të obligueshëm, si sistem i financuar dhe i menaxhuar nga llogaritë e kursimit personal. Pjesëmarrja ishte e kufizuar për anëtarë të rinj, si dhe për ata të rinj të cilët bëjnë pjesë në kontingjentin e punës;
- Shtylla e tretë, vullnetare, pensionet e menaxhuara privatisht, parimisht të organizuara (por jo ekskluzivisht) nëpërmjet punëdhënësve.

Është parashikuar se lidhja midis pagimit të sigurimit dhe përfitimit të pensionit në të ardhmen do të çojë në zvogëlimin e punësimit të fshehtë dhe do të stimulojë aktivitetet ligjore. Sistemi i ri nuk ka ndonjë shtytje në moshën e daljes në pension. Minimumi i moshës për dalje në pension është mosha 60 vjeçare. Ky sistem i ri pensional siguron gjithashtu edhe një garacion minimal pensional për të gjithë ata që arrijnë moshën 60 vjeçare edhe nëse nuk kanë punuar. Ndihma sociale sigurohet edhe për personat të cilët e arrijnë moshën 60 vjeçare, por nuk kanë mbi 10 vjet përvjë pune. Niveli nominal i ndihmës sociale vendoset nga qeveria. Momentalisht është 25 lats (60% e mesatares së pensioneve dhe 20% të mesatares së pagave). Megjithatë, disa pensione të caktuara vazhdojnë të jenë më të privilegjuara. Ato përfshihen në buxhetin e shtetit dhe jo në fondin e sigurimeve shoqërore. Këtu përfshihen pensionet e ushtarakeve, zyrtarëve shtetërorë të punëve të brendshme dhe të drejtësisë dhe pensionet e akademikëve. Pensione të veçanta ka edhe për personat me merita. Të gjitha këto pensione janë disa herë më të larta sesa pensioni i sigurimeve shoqërore. Ekzistojnë dallimet e benefacioneve në mes të sistemit të vjetër dhe të sistemit të ri pensional.

- Në sistemin e vjetër shumica e pensionistëve me vite të plota të punës që dalin në pension, pas moshës 60 vjeçare nuk lejojnë ulje të benefacioneve. Beneficionet janë të larta sidomos për ata që i kanë të ardhurat e larta (të cilët në të ardhmen kontribuojnë më shumë), ndërsa beneficionet janë të ulëta për ata të cilët i kanë të ardhurat e ulëta.
- Në sistemin e ri, dalja e hershme në pension dënohet, p.sh femrat të cilat dalin në pension në moshën 55 vjeçare do të kenë zbritje në pensionet e tyre, nëse i ndërpresim kontributet. Sipas ligjit të ri, pas 10 viteve shpenzimet e pensioneve supozohet të janë më të ulëta për  $\frac{1}{3}$  e atyre që kanë mundur të janë nën sistemin e vjetër. Si rezultat i kësaj, kontributet të cilat shpërndahen për pagimin e pensioneve janë zvogëluar nga 26% në 20% në vitin 2001. Për lituanët nën moshën 40 vjeçare (që do të fillojnë të marrin pensione mbas 20 vjetëve), rrëth 40% të pensioneve të tyre pritet të mëren nga fondi i shtyllës së dytë.

### Kapitulli III : Synimet dhe Objektivat

#### *Synimet*

Synimi kryesor i ndryshimeve në sistemin pensional përmes këtij ligjës së tij që të bëhet rishikimi i disa prej kritereve të 2-3 skemave pensionale të finançuara nga shteti. Problemet dhe vështirësit e paraqitura pas fillimit të zbatimit të Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti, kanë paraqitur nevojën për disa ndryshime në legjislacionin aktual primar dhe sekondar. Përmes këtij projektligji synohet që të krijohen politika më të mira pensionale, krijohen mundësi dhe lehtësira për nënshkrimit të marrëveshjeve për sigurime sociale. Gjithashtu me ndryshimet e projektligjit do të krijohen mundësit e eliminimit keqpërdorimeve dhe penalizmit apo ndëshkimit të disa qytetarëve, të cilët realizojnë të hyrat në kundërshtim me bazën ligjore.

#### *Objektivat*

Objektivat kryesore të politikës sonë të propozuar, konsistonë në:

1. Rishikimin e kritereve për realizimin e të drejtave dhe përfitimeve në pension për të gjithë qytetarët mbi 65 vjeç, që përfitojnë nga skemat aktuale të pensioneve;
2. Garantimin dhe sigurimin e pensioneve të cilat financohen nga buxheti i shtetit për të gjithë qytetarët të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës dhe shtetasve të huaj, të cilët nuk përfitojnë pensione dhe të hyra nga ndonjë skemë tjetër publike apo private, brenda dhe jashtë vendit;
3. Krijimin e mundësive për iniciimin e negociatave dhe nënshkrimin e marrëveshje bilaterale për sigurime sociale në fushën e pensioneve me disa vende të BE-së;

4. Parandalimin e keqpërdorimit të pensioneve përmes krijimit të mekanizmave mbikëqyrëse për ata pensionistë dhe familjarë të tyre që po realizojnë të hyrat në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi.

Për realizimin e këtyre objektivave, MPMS-ja si iniciuese e këtij Konceptdokumenti, ka rishikuar në vazhdimësi kornizën ligjore të fushës pensionale të financuar nga shteti, përmes së cilës do të zhvillojë dhe harmonizojë politikat pensionale sipas standardeve të BE-së dhe kushteve ekonomike të vendit. Bazuar në Planin Vjetor të Qeverisë për vitin 2016, MPMS-ja do të procedojë në Qeverinë e Kosovës për miratim këtë Koncept Dokument deri më 29 shkurt 2016. Pas miratimit të këtij Konceptdokumentit, MPMS-ja do iniciojë dhe përgatitë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti, i cili planifikohet që deri me 30 prill 2016 të marrë miratimin nga Qeveria Kosovës dhe të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës më së largu deri më 30 qershor 2016.

#### Kapitulli IV, V dhe VI: Opcionet, Përbledhja e Opcioneve dhe Analizat

##### *Opcioni 1: Opcioni status quo (asnje ndryshim)*

Korniza aktuale ligjore e fushës së pensioneve, në rast të mos amendamentimit, do të vazhdojë të zbatohet me probleme dhe me ankesa të shumta të palëve, të cilat janë në rritje çdo ditë. Kjo për arsy se ligji në fuqi për skemat pensionale të finançuara nga shteti, nuk po arrin të realizojë të drejtat minimale për disa kategori të pensionisteve, ndërsa disa kategori të pensionistëve po arrijnë të përfitojnë të hyra nga 2-3 skema pensionale brenda apo jashtë vendit.

Në rast të mos ndryshimit të kornizës ligjore, pensionet bazike të moshës do të vazhdojnë të realizohen nga të gjithë qytetarët kosovarë të cilët jetojnë jashtë vendit apo kanë të hyra tjera nga skemat publike apo private. Numri i qytetarëve të moshuar mbi 65 vjeç që jetojnë jashtë Kosovës apo kanë banim të qëndrueshëm në shtetet e ndryshme, konsiderohet të jetë nga 10,000-15,000 qytetarë. Efekti negativ është edhe se këto pagesat (të padrejta) për ata që përfitojnë nga të metat e sistemit të ndjeshëm të ndikimet në buxhetin e Kosovës e zgjegojnë aftësinë për të ofruar pagesat e jetesës për kosovarët tjerë në nevojë. Riorganizimi i sistemit dhe procesit për të siguruar një administrim më të drejtë dhe të drejtë të skemave të pensioneve do të sigurojë kursime dhe potencial për të rritur shumat në dispozicion për të lehtësuar varférinë përfjetuar nga një sasi të konsiderueshme të pensionistëve të moshuar të Kosovës.

Për pensionet kontributaguese, korniza aktuale ligjore, e cila përcakton se përfitues të këtij pensioni mund të janë vetëm shtetasit kosovar, mund të jetë në kundërshtim me parimet e sigurimeve sociale dhe legjislacionin e BE-së. Kjo për arsy se legjislacioni ka përcaktuar se të drejtën e përfitimit në këtë pension e kanë vetëm shtetasit kosovar dhe jo shtetasit e huaj. Korniza aktuale ligjore, ka lënë të hapur mundësinë që kjo çështje mund të rregullohet me nënshkrimin e marrëveshje bilaterale për sigurime sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve përkatëse. Arrija e këtyre marrëveshjeve po

konsiderohet si proces që kërkon kohë dhe është mjaft sfiduese për arsyen e shumta, siç janë: kapacitete të kufizuara njerëzore, mungesë e kornizës ligjore në fushën e sigurimeve sociale, vullnet i pamjaftueshëm nga sektorët e tjera përgjegjës të Qeverisë (MSH, MPB, MPJ, etj.).

#### *Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese /*

Ndryshe nga Status Quo-ja, MPMS-ja si propozuese e këtij Konceptdokumenti, propozon që të ndryshojë kornizën aktuale ekzistuese me këtë model të rekomandimit. Ky opson bazohet në krijimin e reformës në skemat e pensione dhe benefiteve tjera të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës. Kjo reformë, konsiston në hartimin e një ligji bazik dhe sistemor, i cili do të rregullonte të gjitha skemat pensionale dhe invalidore të finançuara nga shteti me një ligj të vetëm. Përveç këtyre skemave, sipas këtij opzioni, politika e re ligjore do të rregullonte edhe përkrahjen financiare për personat me aftësi të kufizuara, duke u bazuar në caktimin e përqindjes së paaftësisë për punë dhe jetë. Sa i përket administrimit të sistemit pensional më këtë politikë do të përcaktohej edhe krijimi i një organi të pavarur apo qendror të administratës shtetërore të Qeverisë së Kosovës, i cili do të menaxhonte dhe administronë të gjitha skemat pensionale dhe invalidore, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare për personat me aftësi të kufizuara, skemat e përfitimeve dhe pensioneve të dalura nga lufta, skemën e të verbërve, skemën e veteranëve, etj. Përveç skemave pensionale, krijimi i një agjencioni të tillë, do të mundëson që të kemi një ndarje në mes të hartuesve të politikave dhe legjislacionit me ekzekutimin apo administrimin e skemave të pagesave sociale të finançuara nga Buxheti i Kosovës. Krijimi i këtij mekanizmi do të duhej të kishte shtrirje në çdo Komunë të Kosovës, në të cilat do të ekzistonte një ONE STOP SHOP për ofrimin e të gjitha shërbimeve në fushën e mirëqenies sociale dhe pensioneve për të gjithë qytetarët dhe të huajt të cilët i plotësojnë kriteret për të përfituar nga skemat e pagesave të finançuara nga Buxheti i Kosovës. Sipas këtij opzioni, propozohet që MPMS-ja, si organ propozues, të hartoje një ligj të ri me emërtimin: Ligji për skemat pensionale dhe invalidore të finançuara nga shteti.

#### *Opsion 3: Ndryshimi i qasjes eskzistuese të zbatimit-Opsioni i REKOMANDUAR*

MPMS-ja, pas rishikimit të kornizës ligjore aktuale, konsideron se opzioni më i mirë për fazën e tanishme është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit në fuqi për skemat pensionale të finançuara nga shteti. Politika e rekomanduar konsiston në këto ndryshime kryesore:

Fillimisht, do të saktësohet definicioni " Banor i Përherëshëm dhe i Përkohshëm " gjithëmon brenda kuptimit të këtij ligji. Definicioni do të harmonizohet me ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat e rregullojnë këtë cështje. Pensionet bazike të moshës nga një pension i bazuar në mbulimin e të ardhurave minimale për të gjithë qytetarët që mbushin 65 vjeç, do të shndërrohej në një Pension Social apo Pension të Shtetit, të cilin do ta përfitonin të gjithë qytetarët mbi moshën 65 vjeçare, që nuk realizojnë ndonjë të hyrë tjetër publike apo private nga skemat e pagesave brenda dhe jashtë vendit. Ky pension, përveç emërtimit do të ndryshojë edhe për nga përmbytja e tij. Të drejtën për të qenë përfitues i këtij pensioni, përveç shtetasëve kosovar, do ta kenë edhe shtetasit e huaj të cilët i plotësojnë kriteret sipas legjislacionit në fuqi. E drejta për të fituar këtë

pension, do të ndërlidhet me dy elemente të reja ligjore, siç janë: caktimi i minimumit të viteve të periudhës së banimit të përhershëm në Kosovëdhe përjashtimi në rastet kur pensionistët kanë të hyra apo te ardhura të llogaritshme të tjera më shumë se vlera e përcaktuar e Pensionit Social apo Pensionit të Shtetit. Në rastet kur pensionistët realizojnë të hyra me pak se vlera minimale e pensionit të përcaktuar, kanë të drejtë të përfitojnë vetëm diferençën e shumës monetare, për të plotësuar vlerën minimale të pensionit. Me këto ndryshime ligjore, pensioni bazik i moshës si pension universal, i cili iu ofrohet të gjithë qytetarëve të Kosovës pa marrë parasysh se a realizojnë të hyra tjera apo jo, do të shndërrohet në Pension Social apo Pension të Shtetit, për të cilin të hyrat e tjera në kesh do të testohen. Pensioni Social apo Pension i Shtetit, nënkupton që të gjithë qytetarët e Kosovës duke i përfshirë edhe të huajt, të cilët janë banorë të përhershëm, kanë mbushur moshën 65 vjeçare dhe të cilët nuk posedojnë të hyra tjera mbi vlerën minimale të pensionit të përcaktuar nga Qeveria e Kosovës, do të kenë të drejtë në realizmin e të drejtave në përfitime nga skema e pensionit social apo pensionit të shtetit. Ky pension do të monitorohet vazhdimesht nga zyrtarët e departamentit përkatës të MPMS-së, kur pensionistët paraqesin dëshmi të rreme mbi vendbanimin e përhershëm, atëherë ndaj tyre do të bëhet verifikimi i gjendjes faktike në terren për një kohë të shkurtër dhe nëse vërtetohet se pensionisti nuk është banor i përhershëm sipas dëshmive të paraqitura në kërkesën e tij, atëherë ndaj tij apo saj, do të ndërmerren masa ligjore konform legjislacionit në fuqi.

Ndryshimet ligjore për pensiononin kontributpagues do të janë edhe në qartësimin e disa kritereve aktuale siç janë periudha e pagesës së kontributeve, dokumentacioni për aplikim, etj. Ndryshimet në **Pensionin e parakohshëm** për të punësuarit e Minierës së Trepçës dhe minierave tjera të Kosovës, do të konsistonë në sqarimin më të detajuar të nenit 10 siç janë ndërprerja e marrëdhënieς së punës pa fajin e të punësuarit, periudha e punësimit, dokumentacioni për aplikim, etj.

**Pensioni i paaftësisë së përhershme**, do të riemërtohet si pension i aftësisë së kufizuar. Koncepti do të mbeten i njëjtë por që do të sqarohen me shumë kriteret për aplikim. Po ashtu, ndryshimet do të bëhen në kriteret e riaplikimit për këtë pension. Këto kritere do të janë sipas standardeve ndërkombëtare të shëndetësisë për aftësinë e kufizuar.

Ndryshimet do të konsistonë edhe në **procedurat administrative** të realizimit të kërkesës për pensione, ku do të shkurtohen afatet përvendimmarrje dhe të ankesave si nga shkalla e parë, ashtu edhe nga shkalla e dyte, sipas Ligjit në fuqi për Procedurën Administrative.

Po ashtu, ndryshimet do të konsistonë në mënyrat e monitorimit dhe inspektimit të pensioneve, bashkëpunimi me institucionet e licencuara për shpërndarjen e pagesave dhe me bankat e Kosovës për llogaritë bankare të shfrytëzuesve të pensioneve, procedurat e lajmërimit dhe suspendimit të pagesave të pensioneve.

#### *Përbledhja e Opcioneve*

Në vijim paraqesim tabelën me opsonet e përbledhura:

| Përbledhja e Opsiioneve                               |   |   |   |
|---|---|---|---|
| Karakteristikat kryesore                              | Opsiuni 1   | Opsiuni 2   | Opsiuni 3   |
| Karakteristikat kryesore të opsonit                   | <p>1. Keqpërdorimi i pensioneve bazike të moshës nga pensionistët të cilët jetojnë jashtë Kosovës.</p> <p>2. Rritja e ankesave dhe pakënaqësive të pensionistëve rreth kritereve ligjore, dokumentacionit aplikues dhe procedurave për të gjitha pensionet e finançuara nga shteti.</p> | <p>1. Hartimit i Ligjtëri i cili do të quhet Ligji për skemat pensionale dhe invalidore të finançuara nga shteti.</p> <p>2. Ligji i ri do të rregullonte edhe format e tjera financiare për personat me aftësi të kufizuar si shërbime dhe kujdes ndaj kësaj kategorie.</p> <p>3. Ligji do të krijonte edhe Agjencionin për pensione dhe beneficione si organ i pavarur brenda Qeverisë së Kosovës.</p> | <p>1. Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjt nr. 03/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti.</p> <p>2. Ndryshimet do te fokusohen në pensionet bazike të moshës, të cilat do të quhen pensione sociale ose pensione te shtetit të testuara.</p> |
| Segmenti i Popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar | Vetëm qytetarët kosovarë me banim të përhershëm në Kosovë mbi moshën 65 vjeçare.  | Të gjithë personat mbi moshën 65 vjeç, të cilët aplikojnë për pensione, siç janë qytetarët kosovar me banim të përhershëm në Kosovë;  | Të gjithë personat mbi moshën 65 vjeç siç janë qytetarët kosovar me banim të përhershëm në Kosovë;  |

|   |   |  |   |
|---|---|--|---|
|   |   | qytetarët kosovarë me banim të përhershëm në Kosovë të cilët janë me aftësi të kufizuara prej moshës 0 deri në vdekje, e të cilët përfitojnë beneficione për shërbime dhe kujdestar personal, varësisht se në cilën kategori caktohen. |   |
| Karakteristikat e zbatimit -kush është përgjegjës- një resor i Qeverisë (cili), sektor privat, qytetarët. | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Departamenti i Pensioneve; Zyrat pensionale të vendosura nëpër komunat e Kosovës; | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ministria e Financave; Agjencioni për pensione dhe beneficione;   | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Departamenti i Pensioneve; Zyrat pensionale të vendosura nëpër komunat e Kosovës; |
| Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit  | -//-  | -//-   | -//-  |
| Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet.      | Vazhdimi i zbatimit të kornizës ligjore në fuqi për skemat pensionale të finançuara nga shteti.                             | Hartimi i Ligjit të rë për skemat pensionale dhe invalidore të finançuara nga shteti.  | Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti.                               |
| Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike-subvencionet ose taksat   | -//-  | -//-   | -//-  |
| Fushatat e edukimit dhe komunikimit   | -//-  | //   | -//-  |
| Afatet kohore - kur hyn   | Ligji aktual ka   | Afati për  | Afati për   |

|                 |  |  |   |
|-----------------|--|--|---|
| në fuqi opzioni | hyrë në fuqi në muajin maj të viti 2014. | miratim nga Qeveria do të jetë 30 tetor 2016. Ndërsa miratimi dhe hyrja në fuqi nga Kuvendi me 30 qershori 2017. | miratim nga Qeveria do të jetë 30 Prill. Ndërsa miratimi dhe hyrja në fuqi nga Kuvendi më 30 qershori 2016. |
|-----------------|--|--|---|

## Përfitimet

### 1. Përfitime pozitive të opzionit 1/Status Quo

Bazuar në opzionin e parë, përfitimet pozitive do të janë vetëm për qytetarët kosovarë të cilët i plotësojnë kriteret e ligjit në fuqi për skemat pensionale të finançuara nga shteti. Varësisht se cilën pension aplikojnë, qytetarët kosovarë, përkatësisht pensionistët do të kenë përfitime pozitive nga ky ligj. Pensionistët bazik të moshës, të cilët sot jetojnë jashtë vendit, mund të vazhdojnë të marrin pensionet e tyre edhe pse kanë paraqitur vendbanim të përhershëm në Kosovë. Këtë situatë e kemi shpjeguar në pikat e shënuara më lartë. Kjo kategori, aktualisht mund të jetë shfrytëzuese i këtij pensioni, por edhe të marrin të hyra, si p.sh. nga trusti pensional, të ardhura mujore të rregullta, etj.

### 2. Përfitimet pozitive për opzionin e dytë

Bazuar në opzionin e dytë, përfitimet do të janë për të gjithë personat mbi moshën 65 vjeç, siç janë qytetarët kosovarë me banim të përhershëm në Kosovë. Përfitimet pozitive do të ishin kryesisht për shfrytëzuesit e pensioneve kontributpaguese, pensionit të parakohshëm të Trepçës dhe të pensionit të paaftësisë së përhershëm.

Përfitime pozitive, do të kishin edhe kategoria e qytetarëve të cilët janë me aftësi të kufizuara prej moshës zero deri në vdekje, të cilët përfitojnë beneficione në shërbime dhe kujdestar personal, varësisht se në cilën kategori përkojnë. Në aspektin e procesit të legjislacionit, Kosova do të kishe një ligj bazik dhe sistemor i cili do të përfshinte të gjitha kategoritë te skemave kontributeve dhe jo kontributeve, të cilët për një mënyrë apo tjetër përfitojnë nga skemat pensionale dhe invalidore të finançuar nga shteti.

Ndërsa në aspektin organizativ të menaxhimit, përfitimet pozitive do të ishin në ndarjen dhe lehtësimin e punëve administrative shtetërore, përkatësisht ndarjen e hartimit të politikave legjislative ne fushën e pensioneve nga zbatimi i këtyre politikave. Me këtë opzion, përfitimet janë të shumta për arsy se do krijoheshin efekte kryesore në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore dhe të shpejta për qytetarët e vendit. Këto shërbime do të organizoheshin dhe funksiononin të pavarrura nga Departamenti i Pensioneve të MPMS-së. Me krijimin e një mekanizmi të tillë, do të bëhet ndarja e roleve për institucionet të cilat merren me hartimin dhe zbatimin e politikave të pensioneve. Politikat relevante të

pensioneve do të hartoheshin nga Departamenti i Pensioneve, ndërsa zbatimi i tyre do të bëhej nga Agjencioni për Menaxhimin e Pensioneve dhe Benefacioneve.

### *3. Përfitimet pozitive për opsonin e tretë*

Bazuar në opsonin e tretë, përfitimet do të ishin për përfituesit e pensioneve të parakohshme dhe pensioneve të paaftësisë së pérhershme të cilëve me ndryshimet ligjore, do të specifikohen dhe lehtësohen procedurat administrative.

Në aspektin financiar, përfitimet pozitive kryesisht do të ishin në kursimet e buxhetit të shtetit dhe krijimin e mundësive për rritjen e vlerës aktuale të pensionit. Buxheti i Kosovës do të përfitonë në reduktim të shpenzimeve të cilat do të arrihen të realizohet nga monitorimi dhe inspektimi i pensionistëve dhe qytetarëve të cilët tentojnë të paraqesin dëshmi të rreme se jar ë banorë të pérhershëm të Kosovës apo mosparaqitjen e rasteve të vdekjeve. MPMS-ja planifikon që përmes ndryshimit dhe plotësimit të kornizës ligjore nga kursimet të bëjë implementin e skemës së pensionebe invaldiore dhe pensioneve familjare .

Ndryshimet dhe plotësimet e reja ligjore, nuk do të krijojnë kosto shtesë për implementuesin e kësaj politike. Përfitimet pozitive, do të konsistonë edhe në aspektin kohor dhe administrativ të implementimit pasi që MPMS-ja, me ndryshimet ligjore, nuk do të krijojë struktura të reja të menaxhimin dhe administrimit. Me aprovimin e kësaj politike dhe hyrjen në fuqi të plotësim ndryshimeve të ligjit, do të kursehen nga Buxheti i Kosovës në mes të 8-10 milion euro në vit, të dedikuara për skemën e pensioneve të moshës, shumë e cila do të mund të shfrytëzohej për implementimin e skemës së pensionit familial dhe pensioni invalidor të punës. Po ashtu, sipas këtij opzioni do të arrihet që të ulet presioni mbi financimet shtesë dhe ad-hoc që shumë here kanë sfiduar qëndrueshmërinë financiare të Buxhetit Kosovës.

### *1. Përfitime negative të opsiomit 1/Status Quo*

Në rast se nuk ndryshohet gjendja aktuale e kornizës ligjore, përkatësisht të konceptit të pensionit bazik të moshës, do të ekzistonë pasoja negative në rritjen e lartë të shpenzimeve dhe pamundësinë e financimit të rritjeve shtesë të vlerës së pensioneve nga Buxhetit i Kosovës. Ky buxhet do të vazhdojë të rritet pasi që përfituesit aktual të pensioneve bazike të moshës, në bazë të kritereve të buta dhe të pamundura për monitorim nga organet përkatëse, do të kenë mundësinë, që të jetojnë jashtë vendit dhe në të njëjtën kohë të marrin pensionet bazike të moshës. Ky shpenzim i buxhetit, bazuar në të dhënat aktuale të popullsisë dhe strukturën kualifikuese, në vitet e ardhshme do të jetë përfituesi kryesor dhe shpenzuesi më i madh i Buxhetit të Kosovës.

Përfitimet negative kryesore në rast të mos ndryshimit të kornizës ligjore aktuale, përkatësisht mos miratimit të ligjit të ri për skemat pensionale dhe invalidore të financuara nga shteti dhe për përkrahjen financiare të PAK-së, do të janë personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk janë përfitues të asnjë skeme pensionale apo tjetër të financuar nga shteti. Mungesa e kornizës ligjore për trajtimin e PAK-së të cilët kanë aftësi të mbetur për punë dhe të cilët nuk kanë vend të pune apo nuk janë në marrëdhënie pune, konsiderohet të jetë kategoria më e cenuar dhe më e pambrojtur e

shoqërisë. Mungesa e kornizës ligjore për kategorizimin e PAK-së sipas aftësisë së mbetur për punë, konsiston edhe në të drejtat e PAK-së, në shërbime dhe kujdestar personal. Këto të drejta, të bazuara në instrumentet ndërkombëtare, njihen si të drejta universale për të cilat shtetet demokratike dhe ligjore, janë të detyruara që t'ia garantojnë me ligjet nacionale. Konventa e UN-it për personat me aftësi të kufizuara, e miratuar edhe me legjislacionin e BE-së, obligon shtetet anëtare dhe ato që aspirojnë të integrohen në BE, që të sigurojnë se PAK-të, kanë të drejtë në shërbime dhe kujdestar personal, me qëllim të lehtësimit të jetës së tyre dhe integrimit të plotë në shoqër.

### *Përfitimet negative për opsonin e dytë*

Shikuar në aspektin finansiar apo buxhetor, në rast të mirati që t'ë këtij ligji, pasojat negative do të ishin drejtpërdrejtë me mos implementimin e tij për arsyet e mungesës së mjeteve financiare. Mungesa e buxhetit për implementimin e këtij ligji, do ta sjellë zbatuesin e tij, përkatesisht Qeverinë e Kosovës, në situatë e cila nuk do ta implementonte në tërësi këtë ligji. Sipas disa analizave, sot në Kosovë, konsiderohen të jenë diku rrëth 200.000 persona me aftësi të kufizuara. Nga kjo shifër, diku rrëth 20.000 persona me aftësi të kufizuara mbulohen nga MPMS-ja përmes skemave pensionale dhe benefiteve të aplikueshme. Gjithashtu, duke ditur se papunësia në vend është akoma e madhe, nuk mund të pritet se kjo kategori do të ketë mundësi që të punësohet në shkallë të lartë.

Prandaj, nëse krahasojmë këto shifra dhe nëse marrim parasysh shkallën e lartë të papunësisë në Kosovë, si dhe duke marrë parasysh mos planifikimin buxhetor për mbështetje financiare për disa nga këto kategori të PAK-së në Kornizën Aktuale të Shpenzimeve, është e pamundur që Qeveria e Kosovës, në fazën e tanishme të implementojë në tërësi këtë ligji. Paaftësia për të financuar zbatimin e bën miratimi i ligjit parëndësishëm.

Ndërsa për pasojat apo përfitimet negative për skemat pensionale të aplikueshme, do të jenë të njëjtë sikurse në opsonin e tretë të cilën do ta shpjegojmë më poshtë.

### *3.Përfitimet negative për opsonin e tretë*

Përfitimet negative apo thënë ndryshe pasojat negative, në rast të mos ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, konsistojnë në ndërprerjen e pensioneve bazike të moshës për shfrytëzuesit aktual dhe aplikuesit e ardhshëm. Këto pasoja janë drejtpërdrejtë për ata pensionistë të cilët janë shtetas të Kosovës, por të cilët jetojnë jashtë vendit. Me ndryshimin e konceptit të pensionin bazik të moshës, pasoja negative do të kenë edhe shfrytëzuesit aktual të pensioneve bazike të moshës, të cilët kanë të hyra apo të ardhura të llogaritshme më shumë se vlera e pagës së pensionit bazik të moshës. Pasoja negative do të kenë edhe ata qytetarë të cilët nuk kanë jetuar për një periudhë të caktuar të pandërprerë në Kosovë para se të arrijnë moshën e pensionimin. Ndryshimet e tillë, do të sjellin shumë pakënaqësi dhe ankesa tek kjo kategori e cila është shfrytëzuese e kësaj skeme.

## *Efekti shpërndarës*

Efekti shpërndarës i kësaj politike, do të ketë shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Të gjitha ndryshimet e tillë ligjore, do të kenë efekt të drejtpërdrejtë në personat e moshuar mbi moshën 65 vjeçare, pa dallim gjinie. Ndryshimet e tillë ligjore nuk do të kenë efekt, në sektorë të veçantë.

### *Kostoja*

Kostoja e përgjithshme e opsonit të rekomanduar është paraqitur në Formularin e Vlerësimit të Ndikimit Financiar, e cila është pjesë e këtij dokumenti.

### **Kapitulli VII: Konsaltimi**

Procesi konsultimeve publike ka filluar me daten 22.01.2016 dhe ka mbaruar më datën 29.01.2016. Gjate këtij procesi, MPMS si organ propozues, ka dërguar për konsultime paraprake këtyre institucioneve:

Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Zyrës për Planifikim Strategjikë të ZKM-së, Zyrë Ligjore të ZKM-së, Agjencionit per Barazi Gjinore të ZKM-së, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Integrimeve Evropiane, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Administratës Publike; Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Avokatit të Popullit dhe Trustit Pensional ne Kosovë.

Nga këto institucione, kemi pranuar komentet nga Ministria e Financave e cila ka rekomanduar qe kursimet nga ky ligj, do te jene për implementimin e skemës se pensionit familjar dhe skemës së pensionit invalidor te punes. Nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë së ZKM-së kemi pranuar komentin që draft Koncepti është hartuar në përputhje me Udhëzuesin për hartimin e Koncept Dokumentit, se problemi është identifikuar, si dhe ka informacione të mjaftueshme per te shpjeguar qellimin e përgjithshem të politikës së propozuar. SKQ, ka rekomanduar, që synimi i politikës sonë, duhet të modifikohet gjë që është bërë pas procesit te konsultimeve.

Politika jonë e propozuar, është dërguar për konsultim publike tek: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtarë, shoqatave të personave me aftësi të kufizuar, shoqates e pensionisteve dhe invalideve te punes, Institut GAP, Institut RIINVEST, Odes Amerikane te Kosoves dhe rrjetit te grupeve te grave te Kosoves.

Nga këto konsultime kemi pranuar komentet nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombetare, rrjeti i grupeve të grave të Kosovës, shoqata e peronava me aftesi te kufizuar “Handikos”.

Të gjitha komentet e pranuara janë shqyrtuar nga ekipi përgjegjës për hartimin e këtij Koncept Dokumenti.

## **Kapitulli VIII: Krahasimi i opzioneve**

Pasojat e opzionit të parë: Mos ndryshimi i situatës aktuale, bazuar në përfitimet pozitive dhe negative si dhe duke marrë parasysh koston buxhetore, vlerësimi i përgjithshëm për pasojat, konsiderohet të jetë negativ. Ky vlerësim, është për arsyen së qytetarët kosovarë, do të vazhdojnë të marrin pensionet bazike të moshës dhe të njëjtën kohë të jetojnë jashtë Kosovës. Ky keqpërdorim, po konsiderohet të jetë edhe faktor kryesor në shpenzimet e lartë të buxhetit të Kosovës nga kjo kategori.

Pasojat e opzionit të dytë: Hartimi i një ligji të ri duke përfshirë të gjitha skemat pensionale dhe invalidore të aplikueshme dhe ato të reja, si dhe krijimi i një Agjencioni të pavarur për menaxhimin e pensioneve dhe benefiteve, për një kohë të shkurtër nuk është e mundur të zbatohet. Ky vlerësimi do të ishte me ndikim negativ në aspektin kohor, organizativ dhe më kryesore në aspekthin financiare. Shikuar në prioritet afatmesëm, ky opzion do të konsiderohet si më i përshtatshmi dhe gjithëpërfshirësi duke përfshirë të gjitha aspektet e mundshme, si: financiare, organizative, gjithëpërfshirëse dhe aspektin administrativ.

Pasojat e opzionit të tretë: Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit në fuqi, krahasuar me opzionin e parë dhe të dytë, në bazë të vlerësimit të përgjithshëm, pasojat apo ndikimi, konsiderohet të jetë më i zbatueshëm dhe i menaxhueshëm. Kjo për arsyen se:

E para- do të ndalohen keqpërdorimet e pensioneve bazike të moshës, do të lejohen që shtetasit e huaj të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës, të jenë shfrytëzues të skemave pensionale (kontributpaguese dhe pensioneve bazike të moshës).

E dyta- me ndalimin e keqpërdorimit të pensioneve, buxhetit të shtetit do t'i kursen mjetet financiare të konsiderueshme.

E treta- me kursimet e realizuara MPMS-ja, planifikon, që të zbatojë edhe dy skemat e tjera, atë familjare dhe invalidore të punës.

Të gjitha këto vlerësime krahasuar me opzionet e tjera, MPMS-ja i planifikon përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit në fuqi, ku do të zbatohet në tërësi ligji dhe do të garantoheshin pensione për të gjithë qytetarët kosovar dhe të huaj, të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me kornizën ligjore.

## **Kapitulli IX : Rekomandimi**

Rekomandimi i MPMS-së për Qeverinë e Kosovës, si organ propozues i këtij Konceptdokumenti, është miratimi i opzionit të tretë të rekomanuar. Përmes opzionit të rekomanuar, do të ndryshohet dhe plotësohet Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Me miratimin e këtij opzioni, MPMS-ja planifikon që Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ta përfshijë në Programin Legislativ të Qeverisë për vitin 2016, ndërsa do ta hartojë dhe procedojë në Qeverinë e Kosovës për miratim më së largu deri më 30 prill 2016.

## **Kapitulli X: Komunikimi.**

Mënyra e komunikimit me akterët, përkatësisht me institucionet dhe grupet e interesit ka qenë e hapur dhe transparente. Politika e propozuar ka qenë fillimisht e publikuar nga vet Ministri i MPMS-së gjatë rishikimit të kornizës ligjore të skemave pensionale të fiancuara nga shteti gjatë vitit 2015. Ministri i MPMS-së, ka mbajtur debate të shumta televizive me shoqatat e pensionisteve dhe ekspert fushave i cili ka shprehur në mënyrë verbale synimet e politikës së propozuar. Për më shumë, Ministri i MPMS-së, është shprehur disa herë edhe para medivave te shkruara për opsonin e rekomanduar të këtij Koncept Dokumenti. Me miratimin e këtij koncepti, MPMS, do të fton të gjithë akterët për të diskutuar dhe marrë pjesë aktive në hartimin e Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për skemat pensionale të finançuara nga shteti.